



Republika e Kosovës/

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria –Vlada-Government

**Ministria e Tregtisë dhe Industrisë-Ministarstvo Trgovine i Industrije/Ministry of Trade and
Industry**

Departamenti i Industrisë/Department Industrije/Department of Industry

RAPORTI VJETOR I ZHVILLIMIT INDUSTRIAL NË KOSOVË PËR VITIN 2014

Volumi i III-të

Dhjetor, 2015

Përmbajtja

<i>Lista e shkurtesave.....</i>	<i>2</i>
<i>Hyrje</i>	<i>3</i>
<i>Metodologjia.....</i>	<i>4</i>
<i>Analiza makroekonomike</i>	<i>5</i>
<i>Bruto Prodhimi Vendor</i>	<i>5</i>
<i>Struktura e BPV-së sipas shpenzimeve</i>	<i>Error! Bookmark not defined.</i>
<i>Struktura e të Hyrave të Përgjithshme të Qeverisë, 2008-2014</i>	<i>8</i>
<i>Fuqia punëtore.....</i>	<i>11</i>
<i>Total Investimet e Huaja Direkte ne Kosove</i>	<i>13</i>
<i>Analiza Sektoriale</i>	<i>14</i>
<i>Prodhimi Vendor.....</i>	<i>14</i>
<i>Numri i ndërmarrjeve sipas sektorëve industrial</i>	<i>15</i>
<i>Fuqia Punëtore</i>	<i>15</i>
<i>Punësimi sipas aktiviteteve ekonomike</i>	<i>15</i>
<i>Investimet e huaja direkte</i>	<i>17</i>
<i>Investimet e huaja sipas aktivitetit ekonomik</i>	<i>17</i>
<i>Investimet e Huaja Direkte sipas Shteteve.....</i>	<i>18</i>
<i>Tregu financiar</i>	<i>20</i>
<i>Norma mesatare vjetore e interesit në kredi.....</i>	<i>20</i>
<i>Norma mesatare vjetore e interesit në depozita</i>	<i>22</i>
<i>Indeksi i Çmimeve.....</i>	<i>22</i>

Lista e shkurtesave

ASK - Agjencia e Statistikave të Kosovës

ATK - Administrata Tatimore e Kosovës

BE – Bashkimi Evropian

BKK - Buxheti i Konsoliduar i Kosovës

BPV - Bruto Prodhimit Vendor

BQK - Banka Qendrore e Kosovës

DI – Departamenti i Industrisë

DK - Dogana e Kosovës

DPI - Divizioni për zhvillimin e Politikave Industriale

IHD - Investimet e Huaja Direkte

IÇK - Indeksit të Çmimeve të Konsumit

IÇP - Indeksit të Çmimeve të Prodhimit

MTI – Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

MTLEQ – Marrëveshja e Tregtisë së Lirë e Evropës Qendrore

NMVID - Norma Mesatare Vjetore e Interesit në Depozita

NMVIK - Norma Mesatare Vjetore e Interesit në Kredi

Hyrje

Në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MTI), ekziston Departamenti i Industrisë (DI), nën mandatin e të cilit, ndër të tjera, është edhe roli i monitorimit dhe analizimit të trendëve të zhvillimit të industrisë në Kosovë. Në këtë drejtim, DI, tanimë, ka ndërtuar një traditë në përgatitjen e raporteve vjetore analitike dhe statistikore mbi zhvillimin e aktiviteteve industriale.

Qëllimi i këtij Raporti Vjetor është paraqitja e trendëve kryesore zhvillimore të ekonomisë së Kosovës, me theks të veçantë në degët kryesore industriale gjatë vitit 2014. Si i tillë, ai është menduar që t'iu shërbejë politikë-bërësve por edhe hisedarëve (firmat operuese të tanishme dhe potenciale nga sektori privat, investitorët e huaj në veçanti, donatorëve, hulumtuesve akademik, etj.) në procesin e zhvillimit ekonomik në Kosovë, duke iu ofruar një pasqyrë më të qartë rreth trendëve kryesore me ndikim në industrinë e vendit. Më konkretisht, përmes këtij Raporti mendohet që të lehtësohet puna e të gjithë akterëve në zhvillimin e politikave, përveç tjerash, bazuar në indikatorë të matshëm.

Njëjtë me vitin e kaluar, përveç indikatorëve kryesor të nivelit sektorial/industrial, janë përfshirë edhe indikatorët e nivelit makroekonomik, tregut financiar, tregut të punës, investimeve të huaja direkte dhe tregtia e jashtme, të cilët ndikojnë në zhvillimin industrial në një mënyrë apo tjetër.

Metodologjia

Qasja e përpilimit të këtij Raporti, i takon asaj përrshkruese dhe pozitive. Me këtë rast analistët e DI-së kanë tentuar që të vënë në pah trendët kryesor në fushën e zhvillimit industrial në Kosovë.

Duke marrë parasysh faktin që ky Raport realizohet për aktivitet ekonomike të zhvilluara në vitin 2014, fokusi i tij bie mbi këtë kohë, por trendët e indikatorëve të paraqitur datojnë nga viti 2009.

Ky Raport bazohet në të dhënat e mbledhura nga institucionet përgjegjëse (ASK, ARBK, ATK, BQK), kurse përpunimi, paraqitja grafike dhe analizimi i tyre është bërë nga Departamenti i Industrisë, përkatësisht, Divizioni për Politika Industriale (DPI).


Analiza makroekonomike

Bruto Prodhimi Vendor

Ekonomia e Republikës së Kosovës ka vazhduar trendin e rritjes edhe gjatë vitit 2014, edhe pse rritja e atij viti (3%) ishte relativisht me e vogël krahasuar me vitin paraprak (5.3%). Për më shumë mbi trendin e normës së rritjes ekonomike, shih Figurën 1.

Në të njëjtën kohë, norma vjetore e BPV-së për kokë banori, në vitin 2014 kishte shënuar një rritje (2.7%) më të vogël se sa ajo e BPV-se, për dallim prej vitit paraprak kur ishte rritur (5.7%) më shumë se kjo e fundit.

Figura 1: Norma e rritjes së BPV-së dhe BPV për kokë banori



Për më shumë, ashtu siç është paraqitur në Tabelën 1, vlera Bruto e Prodhimit Vendor (BPV), në çmime aktuale, gjatë vitit 2014 ishte rritur për €158 milion, që krahasuar me rritjen e vitit paraprak prej €268 milion paraqet një rritje më të vogël prej 41%.

Tabela 1: Indikatorët kryesore makroekonomik, 2008-2014

Viti	BPV (çmime aktuale, në milion €)	Norma e rritjes së BPV-së (aktuale)	Norma e rritjes së BPV-së (reale)
2009	4,070	4.8%	11.2%
2010	4,402	8.2%	4.5%
2011	4,815	9.4%	9.3%
2012	5,059	5.1%	7.7%
2013	5,327	5.3%	5.7%
2014	5,485	3.0%	3.0%

Trend pozitiv u shënua përsëri në rastin e BPV për kokë banori, e që krahasuar me një vit më parë, gjatë vitit 2014 kishte një ngritje prej 3.5%. Kjo ngritje paraqet normën më të ulët që nga viti 2009, e ku ishte 3.1%. Një zhvillim interesant mund të vërehet nga tabela e mëposhtme që përderisa për çdo vit kur ngritja e BPV për kokë banori ka qenë me e vogël se sa e vitit paraprak, në vitin vijues ka qenë relativisht më e lartë krahasuar me atë vit përkatës.

Tabela 2: Indikatorët kryesore makroekonomik, 2008-2014

BPV për kokë banori (në €)	Norma vjetore e BPV-së për kokë banori
2,258	4.5%
2,329	3.1%
2,480	6.5%
2,672	7.7%
2,799	4.8%
2,935	4.9%
3,039	3.5%

Struktura e përbërësve kryesor të BPV-së, shikuar nga qasja e shpenzimeve ka qëndruar e njëjtë, duke filluar nga shpenzimet e konsumit final të ekonomive shtëpiake, dhe vazhduar me Importin e mallrave dhe shërbimeve, eksporti neto, formimi i bruto kapitalit dhe shpenzimet e konsumit final të Qeverisë.


Tabela 3: Struktura e BPV-së sipas shpenzimeve 2008-2014

Kategoria	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
BPV me çmime aktuale	3,882.80	4,069.60	4,402.00	4,814.50	5,058.70	5,326.60	5,485
BPV për kokë banori (Euro)	2,258	2,329	2,480	2,672	2,799	2,935	3,039
Eksporti i mallrave	198.463	165.328	295.957	319.165	276.1	293.842	325

Eksporti i mallrave dhe shërbimeve	608.9	694.9	878	943.4	922.1	927.1	1,089
Eksporti i shërbimeve	392.4	517.6	573	618.5	635.1	622	764
Eksporti neto	1,498.20	1,419.40	1,565.2 -	1,793.30	1,726.80	1,683.60	1,717
Formimi i bruto kapitalit	1,208.70	1,267.40	1,450.60	1,632.40	1,465.10	1,470.90	1,435
Formimi i bruto kapitalit fiks	337.40	390.30	448.50	521.60	544.80	527.00	403
Importi i mallrave (FOB)	1928.2	1935.5	2157.7	2492.3	2507.6	2449.1	2,538
Importi i mallrave dhe shërbimeve	2,107.10	2,114.20	2,443.10	2,736.70	2,648.80	2,610.70	2,806
Importi i shërbimeve	240.8	285.3	386.1	352.8	288.8	313.7	325
Shpenzimet e konsumit final	4,172.20	4,221.60	4,516.50	4,975.50	5,320.40	5,539.30	5,767
Shpenzimet e konsumit final të ekonomive shtëpiake	3,488.90	3,528.50	3,768.20	4,142.30	4,458.10	4,652.40	4,838
Shpenzimet e konsumit final të Qeverisë	659.8	668.1	722.3	802.1	842.1	863.9	929

Në figurën 2, shihet që pjesëmarrja e eksportit të mallrave ende vazhdon të jetë relativisht e ulët në vlerën e përgjithshme të BPV-se. Më konkretisht, gjatë vitit përkatës, ajo përbënte vetëm 9.1% të BPV-se.

Figura 2: Komponentët e BPV-se, sipas qasjes së shpenzimeve, 2014



Struktura e të Hyrave të Përgjithshme të Qeverisë, 2008-2014

Siç mund të shihet nga Tabela 3, burimet kryesore të të hyrave qeveritare, edhe në vitin 2014, nuk kishin pësuar ndonjë ndryshim për dallim nga vitet paraprake. Me konkretisht, ishte pikërisht Tatimi mbi vlerën e shtuar (41.4%), Tatimi në importe pa TVSH dhe Doganën (23.4%), Të hyrat nga tatimet (11.5%), Dogana (9.3%), dhe tatimet tjera aktuale (4.2%), që shërbyen si burimet kryesore të të hyrave. Sidoqoftë, disa burime tjera domethënëse të të hyrave qeveritare, ashtu sikurse edhe në vitet paraprake ishin organizata

ndërkombëtare (1.5%) dhe nga pronat (0.9%). Trend i njëjtë me vitet e kaluara u shfaq edhe sa i përket ri-mbursimeve nga tatime, duke arritur vlerën prej € 30.7 milion apo 2.3% të vlerës totale të BPV-së përkatëse.


Tabela 4: Struktura e të Hyrave të Përgjithshme të Qeverisë, 2008-2014

	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Tatimi mbi vlerën e shtuar -TVSH	363.42	403.11	455.7	540.22	547.82	558.67	558.83
Tatimet në importe duke përjashtuar TVSH dhe Doganën	132.38	150.36	157.62	200	303.02	300.81	315.31
Të hyrat nga tatimet	161.45	127.85	123.27	134.38	149.95	155.37	155.06
Dogana	93.12	98.05	103.85	120.97	117.23	119.08	125.57
Tatimet tjera aktuale	41.22	40.91	42.71	53.59	69.74	72.42	73.06
Shitjet	45.37	53.37	50.09	52	55.64	51.71	56.94
Tatimet tjera në Prodhim	18.12	15.42	30.31	40.69	25.01	37.41	37.18
Bashkëpunimi me Organizatat ndërkombëtare	17.61	0	16.75	31.37	55.16	25.12	20.57
Transferet tjera të ndryshme	7.97	8.26	9.43	10.01	7.78	7.52	14.77
Të hyrat nga Prona	1.79	2.91	1.58	1.45	1.73	1.65	12.21
Dividenta	0	200	83.24	61.48	44.07	31.82	8.81
Të ardhurat Kapitale	1.5	1.33	1.36	1.6	1.61	1.61	1.59
Transferet tjera kapitale	0.62	0	0	0.43	0.94	0.22	0.28
Të hyrat nga Korporata	8.61	0.02	0.04	0.07	0.04	0.55	0.2
Net primet e sigurimit jo jetësor	0.02	0.23	0.08	0.37	0.06	0.05	0.12
Tatimi në Produkte, përjashtuar TVSH dhe tatimet e importit	74.37	60.03	78.43	88.68	5.85	0.13	0.07
Interesi	8.78	5.43	11.72	1.63	0	0	0
Posedimi i të gjitha aseteve	0	0	0	0	29.14	26.3	0

Të tjera	-0.18	0.01	0	0.03	0.01	0.01	0
Transferrat aktuale brenda qeverisë së përgjithshme	5.11	0	-0.11	-0.56	-0.02	-0.09	-0.02
Tatimi dhe dogana në import duke përjashtuar TVSH	-0.07	-0.09	-0.08	-0.04	-0.34	-0.61	-0.37
Rimbursimet nga tatimet	-21.32	-24.81	-27.02	-27.12	-31.05	-34.02	-30.7
Gjithsej	959.88	1142.39	1138.97	1311.26	1383.41	1355.72	1349.48

Rreth 99% e BPV-se të njehsuar sipas qasjes së të hyrave, gjatë vitit 2014 burojnë nga kategoritë e paraqitura në figurën e mëposhtme. E njëjta situatë ka ngjarë edhe në periudhën kohore 2008-2013.

Figura 3: Burimet kryesore të të hyrave



Fuqia punëtore


Sa i përket fuqisë punëtore, gjatë vitit përkatës, pjesëmarrja e përgjithshme në fuqinë punëtore shënoi një ngritje, (41.6%) krahasuar me vitin paraprak (36.9%). Kjo rritje kryesisht erdhi si pasojë e rritjes së pjesëmarrjes në fuqinë punëtore të meshkujve, e që krahasuar me vitin paraprak kur ishte 55.4%, vitin 2014 arrin vlerën 61.8%. Poashtu edhe pjesëmarrjeve të femrave në fuqinë punëtore shënoi një ngritje duke arritur vlerën prej 21.4%, krahasuar me vitin paraprak që kishte vlerën vetëm 17.8%.

Tabela 5: Pjesëmarrja në fuqinë punëtore 2012-2014

	2012	2013	2014
Pjesëmarrja në fuqinë punëtore (në %)	40.5%	36.9%	41.6%
Pjesëmarrja e femrave në fuqinë punëtore (në %)	21.1%	17.8%	21.4%
Pjesëmarrja e meshkujve në fuqinë punëtore (në %)	60.2%	55.4%	61.8%

Ndërkaq, pjesëmarrja e përgjithshme në fuqinë punëtore gjatë vitit 2014, mori kurs tjetër (pozitiv) krahasuar me vitin paraprak (negativ), duke shënuar një ngritje prej rreth 12.7%. Trend i njëjtë u shënuar edhe në rastin e pjesëmarrjes së femrave dhe meshkujve në fuqinë punëtore, prej 3.6% dhe 6.4%, respektivisht.

Figura 4: Pjesëmarrja në fuqinë punëtore 2012-2014




Trendi në ngritje i papunësisë vazhdoj edhe gjatë vitit 2014. Në krahasim me vitin paraprak, shkalla e përgjithshme e papunësisë u ngrit në 35%, nga 31% sa ishte. Situata u përkeqësua relativisht më shumë tek rasti i meshkujve ku norma e papunësisë u ngrit për 5 pikë % apo 17.8%, nga 28% sa ishte ne vitin 2013, ne 33%.

Tabela 6: Shkalla e papunësisë 2012-2014

	2012	2013	2014
Shkalla e papunësisë e përgjithshme (ne %)	30.0%	30.9%	35.3%
Shkalla e papunësisë tek femrat (ne %)	38.0%	40.0%	41.6%
Shkalla e papunësisë tek meshkujt (in %)	26.9%	28.1%	33.1%

Në Figurën e mëposhtme, mund të shohim që femrat ende vazhdojnë të qëndrojnë relativisht në pozitë më të pafavorshme në tregun e punës, duke pas parasysh nivelin e tyre relativisht më të lartë të papunësisë. Ajo çfarë mund të veçohet si pozitive në këtë rast, ka të bëjë me ndryshimin vjetor të shkallës së papunësisë në mes të femrave dhe meshkujve, ku ajo e para gjatë vitit 2014 shënoi një ngritje relativisht më të vogël.

Figura 5: Shkalla e papunësisë 2012-2014



Total Investimet e Huaja Direkte në Kosovë


Investimet e Huaja Direkte gjatë vitit 2014 shënuan një rënie të dukshme prej 46%, krahasuar nga vitin paraprak. Me fjalë të tjera, ashtu siç mund të shihet në Tabelën në vazhdim, nga 280.2 milion euro sa ishin në vitin 2013, IHD –të zbritën në 151.2 një vit më vonë.

Tabela 6: Investimet e Huaja Direkte (ne mill euro)

Viti	Investimet e Huaja Direkte
2007	440.7
2008	369.9
2009	295.5
2010	368.5
2011	384.4
2012	229.1
2013	280.2
2014	151.2

Për më shumë, kjo paraqet shkallën më të lartë të rënies qysh nga periudha e pas-pavarësisë. Një rënie e ngjashme kishte ndodhur në vitin 2012, prej rreth 40% krahasuar me një vit më parë. Sidoqoftë, pothuajse pas çdo viti kur është shënuar rënie e investime të huaja direkte, ka pasuar një ngritje në vitin e ardhshëm, respektivisht, përveç në rastin e vitit 2008 dhe 2009 ku për dy vite me radhë pati një rënie te tyre.

Figura 6: Investimet e Huaja Direkte (në mil euro)



Analiza Sektoriale

Prodhimi Vendor


Këto të dhëna paraqesin sektorë të ndryshëm industrial sipas numrit të ndërmarrjeve prodhuese, numrit të punësuarve dhe qarkullimit vjetor.

Figura 7 : Sektori i Industrisë përpunuese sipas NACE

Sektori i industrisë përpunuese sipas nace rev 2	Ndër. prodhuese		Numëri i të punësuarëve		Qarkullimi i vjetor	
	Vlera	%	Vlera	%	Vlera	%
10 Përpunimi i produkteve ushqimore	1,286	24.5	4,229	21.9	184,674,330	20.6
11 Prodhimi i pijeve	90	1.7	1,418	7.3	113,052,119	12.6
12 Prodhimi i produkteve të duhanit	4	0.1	97	0.5	334,750	0.0
13 Prodhimi i tekstilit	141	2.7	962	5.0	16,754,706	1.9
14 Prodhimi i veshjeve	285	5.4	444	2.3	4,759,155	0.5
15 Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkurës	42	0.8	262	1.4	4,098,625	0.5
16 Prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës,	577	11.0	1,044	5.4	30,528,820	3.4
17 Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës	99	1.9	185	1.0	11,683,289	1.3
18 Shtypja dhe riprodhimi i mediave të incizuara	228	4.3	484	2.5	11,899,644	1.3
19 Prodhimi i koksit dhe produkteve të rafinuara të naftës	7	0.1	6	0.0	1,184,042	0.1
20 Prodhimi i produkteve kimike	123	2.3	675	3.5	42,576,934	4.7
21 Prodhimi i produkteve bazë farmaceutike dhe	17	0.3	75	0.4	1,104,024	0.1
22 Prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës	473	9.0	1,847	9.6	81,516,971	9.1
23 Prodhimi i produkteve minerale jometalike	527	10.0	3,244	16.8	169,189,296	18.8
24 Prodhimi i metaleve	132	2.5	1,032	5.3	113,051,127	12.6
25 Prodhimi i produkteve të fabrikuar metalike	668	12.7	1,670	8.6	59,207,116	6.6
26 Prodhimi i kompjuterëve, produkteve elektronike dhe	26	0.5	40	0.2	7,026,713	0.8
27 Prodhimi i pajisjeve elektrike	49	0.9	126	0.7	5,624,417	0.6
28 Prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve p.k.t.	25	0.5	76	0.4	2,375,767	0.3
29 Prodhimi i mjeteve motorike, rimorkiove dhe	6	0.1	13	0.1	300,131	0.0
30 Prodhimi i mjeteve të tjera të transportit	8	0.2	37	0.2	1,363,917	0.2
31 Prodhimi i mobilieve	339	6.4	1,259	6.5	31,058,632	3.5
32 Prodhimi tjetër p.k.t.	93	1.8	96	0.5	3,542,557	0.4
33 Riparimi dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve	14	0.3	15	0.1	730,316	0.1
Gjithsej	5,259	100	19,336	100	897,637,398	100

Sa i përket qarkullimit vjetor, me poshtë janë radhitur sektorët e industrisë përpunuese sipas shumës së qarkullimit vjetor në përqindje. Nga ky ilustrim shohim se përpunimi i produkteve ushqimore (10) ka pasur përqindjen më të lartë të qarkullimit në krahasim me sektorët e tjerë përpunues. I dyti sektor industrial me qarkullim me të madh është prodhimi i produkteve minerale jo metalike duke vazhduar me prodhimin e pijeve, prodhimin e metaleve, prodhimin e produkteve të gomës dhe plastikës e tjera.

Figura 8 : Qarkullimi vjetor sipas nën sektorëve



Numri i ndërmarrjeve sipas sektorëve industrial


Duke u bazuar në të dhënat e ofruara si dhe duke iu referuar tabelës së vendosur më lartë, mund të vërejmë se si janë koncentruar ndërmarrjet nëpër sektorë të ndryshëm industrial. Të dhënat sugjerojnë që sektori i përpunimit të ushqimit vazhdon të mbetet lider edhe në koncentrimin e ndërmarrjeve me 1286 sosh. Më pas vjen sektori i prodhimit të produkteve të fabrikuara të metalit me 668 ndërmarrje aktive, duke vazhduar me ndërmarrjet që merren me prodhimin e drurit dhe të produkteve të drurit, prodhimi i produkteve minerale jo metalike etj. Ndërsa, ndërmarrjet që merren me prodhimin e produkteve të duhanit, mjete motorike, dhe riparimi dhe instalimi i makinerive vazhdojnë të jenë sektorë me numrin me të vogël të ndërmarrjeve të koncentruara.

Fuqia Punëtore

Punësimi sipas aktiviteteve ekonomike

Prodhimi, së bashku me arsimin dhe ndërtimtarinë, përbënin pothuajse gjysmën e personave të punësuar në vitin 2014.


Figura 9, Punësimi në prodhim



Nga gjithsej 21 aktivitete ekonomike që përbëjnë një total prej 325,700 të punësuarve , në prodhim janë të angazhuar 44,900 punëtorë. Ky indikator potencon edhe më tepër rëndësinë e prodhimit sa i përket nivelit të punësimit. Në baza gjinore, nga 325,700 të punësuar gjithsej, 250,100 prej tyre janë meshkuj, ndërsa 75,600 janë femra. Këto të dhëna statistikore përfshijnë edhe aktivitetet e prodhimit të mallrave të pa diferencuar dhe shërbimeve të ekonomive familjare private për përdorim vetanak.

Sa i përket punësimit në raport me sektorët e ndryshëm të prodhimit të dhënat tregojnë se sektori i përpunimit të produkteve ushqimore ka të punësuar rreth 21% të fuqisë punëtore. Ky sektor është identifikuar si sektor strategjik, së bashku me 5 sektorë tjerë, i cili ka potencial zhvillimi të mëtutjeshëm në të ardhmen. Sektori i dytë më i madh për nga numri i punëtoreve është sektori i prodhimit të mineraleve jo metalike, i cili përfshinë 16.8% të fuqisë punëtore.

Figura 10 Numri i të punësuarve



Investimet e huaja direkte


Për dallim nga viti 2013, investimet e huaja direkte në vitin 2014 pësuan rënjë. Nga 250.2 milion euro që ishin në vitin 2013, në vitin 2014 kjo shifër ra në 123.9 milion euro. Sipas Bankës Botërore, ndër shkaktarët kryesorë që i atribuohet rënies së investimeve direkte janë edhe shitjet e aksioneve të disa prej kompanive të huaja që operojnë në Kosovë tek rezidentët kosovar si dhe shpërndarjes së super dividendës së disa prej kompanive të huaja që operojnë në Kosovë. Me super dividendë kuptohet dividendë e cila është më e lartë se sa fitimet e kompanisë për periudhën përkatëse. Shpërndarja e super dividendës ndikon në zvogëlimin e kapitalit të huaj aksionar, gjë e cila paraqet zvogëlim të IHD-ve.

Investimet e huaja sipas aktivitetit ekonomik

Banka botërore ka paraqitur investimet e huaja direkte sipas 4 tremujoreve të vitit 2014. Këto të dhëna janë paraqitur për 14 sektorë të ndryshëm, duke përfshirë industrinë si sektor në vete. 13 sektorë të tjerë të përfshirë janë: Bujqësia, Minierat, Energjetika, Ndërtimi, Shërbimet tregtare, Hotele dhe Restorante, Transporti dhe Komunikimi, Shërbimet Financiare, Patundshmëria, Qiradhënia dhe aktivitete tjera biznesore, Shërbimet e tjera, Aktivitete të tjera të pa klasifikuara

diku tjetër. Në tabelën e mëposhtme janë të ilustruara këto të dhëna duke parë se si ka qëndruar industria në raport me 13 sektorë të tjerë sa i përket investimeve të huaja direkte.

Figura 11 Investimet e Huaja Direkte totale në raport me IHD në Industri




Këto të dhëna tregojnë që në tremujorin e parë të vitit 2014, përderisa të hyrat totale të investimeve të huaja direkte në 14 sektorët kanë shënuar rritje prej 42.7 Milion Euro, në sektorin e industrisë kemi pasur një rënie prej 6.6%. Vetëm në tremujorin e tretë të vitit 2014. Kur investimet e huaja direkte patën një rritje të konsiderueshme, investimet e huaja direkte në industri shënuan një rritje pozitive prej 4.6 Milion euro, në krahasim me ato totale që shënuan rritje deri në 82.6 Milion euro.

Investimet e Huaja Direkte sipas Shteteve

Nga 151,1 Milion euro investime të huaja direkte që u realizuan gjatë vitit 2014, tabela e mëposhtme ilustron të hyrat e IHD-ve sipas shteteve të ndryshme.

Figura 12. Investimet e Huaja Direkte sipas shteteve



Siç shihet në tabelë, Zvicra është shteti kryesor me investimet më të larta direkte në Kosovë. Gjatë vitit 2014, ky shtet investoi një shume prej 38.1 Milion Euro. Më pas, në radhë të dytë qëndron Austria me një shumë investimi prej 30.3 Milion Euro. Pjesa tjetër dërmuese e investimeve të huaja direkte gjatë vitit 2014 është pranuar nga shtete si: Gjermania, Shqipëria, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Turqia, Bulgaria Franca, etj.

Tregu financiar


Dallim relativisht I lartë në mes të normave të interesit të kredive dhe depozitave të reja, u shënua edhe gjatë vitit 2014. Në të vërtetë, dallimi në mes normës së interesit të këtyre dy elementeve ka vazhduar të jetë rreth 10%. Sidoqoftë, gjatë vitit 2014, ky dallim u ngrit nga 8.4% në 9.5% (një ngritje prej 13.2%).

Tabela 7: Normat efektive të interesit të kredive dhe depozitave te reja, 2010-2014

	2010	2011	2012	2013	2014
Norma e interesit ne depozita te reja	3.7%	3.5%	3.6%	3.4%	1.1%
Norma e interesit ne kredi te reja	14.4%	13.8%	12.7%	11.8%	10.6%

Zgjerimi i dallimit të përmendur më lartë, mund të zbërthehet në masë të madhe duke e marrë parasysh ndryshimin e normës së interesit në depozita të reja të periudhës përkatëse. Fakti që kjo e fundit pësoi një rënie prej 2.3 pikë apo 67.5% (nga 3.4% në 1.1%) prej vitit 2013 në 2014, në njërin anë, dhe ngritja e normës së interesit të kredive të reja për të njëjtën periudhë kohore prej 10.2%, në anën tjetër, shërben si provë e konstatimit të mëhershëm.

Figura 13 Normat e interesit



Norma mesatare vjetore e interesit në kredi

Trendët e normave të interesit, në kuptimin e renditjes relative sipas vlerës së tyre, për llojet e kredive të paraqitura më poshtë, ishin relativisht të njëjtë me vitin paraprak. Në krye të kësaj

liste qëndron norma e interesit për kreditë bujqësore (13.2%), ndjekur nga ajo e kredive konsumuese (10.9%), shërbyese (10.7%), norma e interesit në kredi të reja (10.6%).

Në terme relative, tri ndryshimet vjetore më të dukshme të normave të interesit u shënuan tek kreditë hipotekare mbi 10 vite, kreditë hipotekare deri në 1 vit, dhe kreditë bujqësore, ku mesatarja vjetore përkatëse gjatë vitit 2014 u ngrit për 11.4%, u zbrit për 31.2% dhe 24.1%, respektivisht, krahasuar me vitin paraprak.

Në anën tjetër, norma e interesit më pak e luhatshme ka qenë ajo e kredive konsumuese, e cila gjatë vitit 2014 krahasuar me vitin paraprak, pësoi një rënie prej 6.3%, ngjashëm me ndryshimin e pësuar gjatë vitit paraprak (6.7%).

Tabela 8: Normat efektive të interesit të KTD-ve në kredi, 2010-2014

Kodi Serik	Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014
T	Norma e interesit ne kredi te reja	14.4	13.8	12.7	11.8	10.6
T_3	Kreditë konsumuese	13.9	12.7	12.4	11.6	10.9
T_4	Kreditë hipotekare	11.8	11.5	10.6	10.1	9.1
T_4a	Deri në 1 vit	7.1	2.2	7.1	8.1	5.6
T_4e	Mbi 10 vite	8.2	8.9	8.7	7.6	8.5
T_61	Bujqësore	25.7	23.7	20.7	17.4	13.2
T_62	Industriale	12.6	13.9	12.5	12.3	10.4
T_63	Shërbyese	14.2	13.9	13.2	11.9	10.7

Norma mesatare vjetore e interesit në depozita


Ashtu siç mund të vërehet në Tabelën e mëposhtme, norma e interesit në depozita të reja gjatë vitit 2014, krahasuar me vitin paraprak, shënoi një rënie nga 3.42% në 1.11%. Në të njëjtën kohë, normat e interesit në depozita me afat deri në 1 muaj dhe mbi 2 vite shënuan një zbritje nga 2.23% në 1.44%, dhe 5.16% në 3.27%, respektivisht.

Tabela 9: Normat e interesit në depozita, 2012-2014

	2012	2013	2014
Norma e interesit në depozita të reja	3.60	3.42	1.11
Deri në 1 muaj	0.93	2.23	1.44
Mbi 2 vite	2.15	5.16	3.27

Për më shumë, duke iu referuar Figurës së mëposhtme, ku janë paraqitur ndryshimet vjetore të normave të interesit të depozitave përkatëse, mund të vërehet që ndryshimet më të mëdha në terme relative gjatë vitit 2014 krahasuar me vitin paraprak pasuan në rastin e normave të interesit tek depozitat e reja. Me konkretisht, zbritja e normës së interesit në këtë lloj të depozitave, gjatë vitit 2014 në krahasim me vitin paraprak ishte -68%, ndjekur nga ajo e depozitave në afat 1 muaj -35%, dhe depozitat mbi dy vjet -1.89%.


Figura 14. Ndryshimet vjetore të normës së interesit në depozita, 2012-2014



Indeksi i Çmimeve

Nga Figurën e mëposhtme mund të shihet një trend vazhdimisht në rritje të çmimeve të konsumit, edhe pse gjatë tri viteve të fundit një shkallë e tillë ka qenë relativisht më e stabilizuar. Sa i përket çmimeve të prodhimit dhe importit, mund të vërehet një tendencë për nivelim të ngritjeve vjetore gjatë dy viteve të fundit, në veçanti. Pavarësisht kësaj, qysh nga viti 2010, kur ndryshimi vjetor i çmimeve të këtyre dy kategorive ishte i njëjtë, çmimet e importit në vazhdimësi shënuan një ngritje vjetore relativisht më të lartë se sa ato të prodhimit.

Figura 15: Ndryshimet vjetore të çmimeve të Prodhimit, Konsumit dhe Importit, 2009-2014



Nga Tabela e mëposhtme, mund të përfundohet që në terme relative, gjatë vitit 2014 krahasuar me vitin paraprak, ndryshimet më të mëdha në çmime kanë ndodhur tek ato të konsumit (27.6%), ndjekur nga ato të importit (14.7%) dhe të prodhimit (10.9%).

Tabela 10: Indekset e Çmimeve të Prodhimit, Konsumit dhe Importit, 2009-2014

Viti	Indeksi i Çmimeve të Konsumit (Maj 2002=100)	Indeksi I Çmimeve të Prodhimit (Maj 2010=100)	Indeksi i çmimeve të importit (IÇIMP)(2010 = 100)
2009	9.7	-3.9	-5.9
2010	13.5	0.001	0.001
2011	21.8	4.6	9.3
2012	24.8	6.6	15
2013	27	9.1	15.2
2014	27.6	10.9	14.7

Në anën tjetër, nëse e analizojmë shkallën e ngritjes së çmimeve për të njëjtën periudhë kohore të lartë theksuar, vërejmë që çmimet e prodhimit renditen në vendin e parë, ku vlera e shkallës përkatëse arriti vlerën 20%, ndjekur nga ato të konsumit dhe importit, me 2% dhe -3% , respektivisht. Sidoqoftë, përkundër faktit që konsumatorët u ballafaquan me ngritje më të lartë të çmimeve (në krahasim me prodhuesit dhe importuesit), ndryshimi në ngritjen vjetore të shkallës dhe për periudhën në fjalë ishte më e ulëta (vetëm 2%) qysh se nga viti 2009. Paralelisht në kohë, ndryshimi i ngritjes vjetore i çmimeve të prodhimit ishte 20%, ndërkaq ajo e çmimeve të importit -3%.